



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

PML.nr.60/2025

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përberë nga gjyqtarët Agim Maliqi, kryetar, Mejreme Memaj e Afrim Shala, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale të dënuarve Arman Elezkurtaj dhe Bekim Elezkurtaj, që të dy nga fshati ..., komuna e P., për shkak të veprave penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, parashikuar me nenin 267 par.2 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm, parashikuar me nenin 294 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesat e mbrojtësve të dënuarve për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.2/2024 datë 29 maj 2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me 20 shkurt 2025, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat e mbrojtësve të dënuarve Arman Elezkurtaj dhe Bekim Elezkurtaj për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitura kundër aktgjykimit formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.2/2024 datë 29 maj 2024.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr./2024 datë 29 maj 2024, të pandehurit Arman Elezkurtaj e Bekim Elekurtaaj janë shpall fajtor për shkak se si bashkëzekutor kanë kryer veprat penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, parashikuar me nenin 267 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm, parashikuar me nenin 294 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kurse i pandehuri Tafil Badalli për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, parashikuar me nenin 267 par.2 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, dhe pasi që të pandehurve Arman e Bekim u është caktuar dënimi me burgim për secilën vepër penale, konform dispozitës së nenit 76 par.1 e 2 nënpar.2.2 të KPRK, janë gjykuar secili veç e veç me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej njëzet e katër muajve (24), në të cilat u është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 30 gushtit 2023 deri me 29 maj 2024, dhe me dënime me gjobë secili në shumë prej nga 1000( njëmijë)€ të cilat janë obliguar që ta paguajnë në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast se nuk mund ta paguajnë apo nuk dëshirojnë të njëjtat do tu zëvendësohen me gjobë ashtu në një ditë burgimi do tu llogariten 20€ të gjobës .

Në procedurën ankimore sipas ankesës së Prokurorit dhe mbrojtëseve të të dënuarve aktgjykimi i lartcekur është vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR.nr.433/2024 datë 5 nëntor 2024.

Kundër aktgjyqimeve të lartcekura kanë paraqitur kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë:

-mbrojtësit e të dënuarit Arman Elez Kurtaj ( kërkesë të përbashkët), avokatët Hazër Susuri e Elinda Susuri, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që kërkesa të aprovohet aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim apo të ndryshohen ashtu që ndaj të dënuarit të shqiptohet dënim me i ultë;

-mbrojtësi i dënuarit Bekim Elez Kurtaj, avokati Rinard Pulaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që kërkesa të aprovohet aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim apo të ndryshohen ashtu që ndaj të dënuarit të shqiptohet dënim me i ultë.

Prokurori i Shtetit me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr. 27/2025 datë 5 shkurt 2025, ka propozuar që kërkesat të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoj pretendimet në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesat nuk janë të bazuara.

Fillimisht vlen të theksohet se pretendimet në kërkesat e mbrojtësve të të dënuarve janë të njëjta. Në fakt pretendohet se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 të KPP, sepse nuk janë paraqitur arsye për faktet vendimtare sa i përket dënimeve të shqiptuara, kushteve ligjore për dënimet e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 24 muajve dhe nuk janë përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 70, 71 e 72 të Kodit Penal. Sipas mbrojtësve dispozitivi i aktgjykimit është kundërthënës me arsyetimin e aktgjykimit sa i përket dënimit të shqiptuar, sepse nuk janë paraqitur arsye për faktet vendimtare përkitazi me kushtet e zbutjes së dënimit. Kurse, sa i përket shkeljes së ligjit penal pretendojnë se është shkelur ligji penal, për shkak se dënimet e shqiptuara me burgim janë të larta dhe nuk janë vlerësuar në masë të duhur kushtet për zbutjen e dënimit konform dispozitës së nenit 69, 70, 71, 72 e 73 të kodit penal ngase në rastin konkret ka pas kushte ligjore që të dënuarve tu zbutet dënimi dhe tu shqiptohet dënim me i ultë me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit. Në fakt sipas kërkesave gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë, fatin se të dënuarin për herë të parë kanë ra ndesh me ligjin, kishin sjellje korrekte, janë penduar dhe kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të bien ndesh me ligjin, por këto rrethana nuk i kanë vlerësuar drejt, ngase në praninë e tyre edhe me ndonjë dënim me të butë do të mund të arrihej qëllimi i dënimit.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të lartcekura kjo gjykatë vlerëson se ato janë të pabazuara për këto arsye:

Vlen të theksohet se mbrojtësit e të dënuarve edhe pse i kundërshtojnë aktgjykimet e kundërshtuara për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal nga përmbajtja e kërkesës del se e kundërshtojnë vetëm vendimin mbi dënimin.

Sipas dispozitës së nenit 432 të KPP ndaj vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet në rast të shkeljes së ligjit penal, në rast të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 i këtij kodi ose në rast të shkeljeve tjera të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Pra, bazuar në këtë dispozitë kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të vendimit për dënim.

Në fakt pretendimet e mbrojtësve sa i përket shkeljeve të dispozitave të procedurës penale se gjykatat nuk ka dhënë arsye sa i përket fakteve vendimtare për dënimin, nuk janë të bazuara sepse, gjykatat e shkallës së parë ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat i kanë marr parasysh me rastin e caktimit të dënimit. Në të vërtetë mbrojtësit edhe pse pretendojnë se gjykatat nuk kanë dhënë arsye në këtë drejtim, nga përmbajtja e kërkesave del se e kundërshtojnë lartësinë e dënimeve të shqiptuara duke theksuar se nuk janë vlerësuar drejt rrethanat lehtësuese me pretendim se në praninë e rrethanave lehtësuese dhe dispozitave ligjore për zbutje të dënimit është dashur të shqiptohet një dënim me i ultë me burgim apo nën minimumin e paraparë ligjor me të cilin do të mund të arrihej qëllimi i dënimit. Mirëpo, pavarësisht faktit se të dënuarit e kanë pranuar fajësinë dhe rrethanave tjera lehtësuese konform dispozitës së nenit 71 të KP është në diskrecion të gjykatës që të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj. Në fakt a është adekuat apo në proporcion me peshën e veprës penale dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është çështje që mund të kundërshtohet me ankesë në gjykatën e shkallës së dytë dhe vetëm shkalla e dytë ka diskrecion që ta ndryshoj vendimin në këtë drejtim, por vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë sa i përket caktimit të dënimit - llojit dhe lartësisë së dënimit nuk mund të kundërshtohet me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, prandaj pretendimet në këtë drejtim kjo Gjykatë i konsideron si të pabazuara.

Kurse, vendimi mbi dënimin mund të kundërshtohet me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në kuadër të shkeljes së ligjit penal vetëm në rast se gjykatat me rastin e marrjes së vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale kanë tejkalar kompetencat ligjore e që paraqet shkelje të ligjit penal ( neni 385 par.1 nënpar.1.5 i KPP).Gjykata i tejkalon kompetencat ligjore kur shqipton dënimin i cili nuk mund të shqiptohet nën minimumin e veçantë ose mbi maksimumin apo shqipton lloj tjetër të dënimit i cili nuk mund të shqiptohet për atë vepër penale. Në rastin konkret gjykatat kanë shqiptuar dënime me burgim në kuadër të minimumit dhe maksimumit të dënimit me burgim që parashihet me ligj për veprat penale për të cilat të dënuarit janë shpall fajtor.

Nga arsyet e lartcekura kjo Gjykatë konform dispozitës së nenit 437 të KPP vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË**  
PML.nr.60/2025 datë 20 shkurt 2025

Procesmbajtësi  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit  
Agim Maliqi